

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E KATËRT

IV

Përktheu: Dr.Musli Verbani
Imam i QIKSHN-së

Oslo, 2010

HYRJE

Falënderojmë Allahun – Krijuesin e gjithësisë, përshëndesim dhe dërgojmë salavate për pejgamberin besnik, ndërmjetësuesin e Ditës së Gjykimit. Qëllimi kryesor i yni të jetë rruga drejt Allahut. Nuk ka forcë, as pushtet të ndryshojë dikush diçka, pos Allahut.

Njerëzit e kësaj kohe, kush punon nuk fiton dhe kush fiton nuk ka fituar. Nuk frikohem prej njerëzve kur frikësohen, por frikësohem se ata nuk frikësohen. Kush frikësohet shpëton. Fatkeqësia është te botëkuptimi, i cili është fatkeqësia më e madhe e shpirtit të njeriut, sepse kriminelët, por edhe të tjerët e dinë se janë gabim, por paraqiten thuaja se nuk ka ndodhur asgjë, dhe se ata janë të drejtë, e kështu ata tregohen kryeneçë, kryelartë dhe ziliqarë. Dhe kur t'i kthehen vetes së tyre e kuptojnë vetë se ata janë duke e tradhtuar vetveten e tyre. Tragjedia është në atë se një pjesë të madhe të jetës së tyre e kalojnë në zbavitje e dëfrim. Nuk e pranojnë dhe nuk i dorëzohen realitetit, por vazhdojnë me avazin e tyre, derisa të kalojë pjesa më e madhe e jetës së tyre, e kur të plaken, dhe kur qëllimi dhe mendimet e tyre marrin fund dhe fillon faza e fundit e fazës së tyre, e kuptojnë realitetin, pasi që veç paralizohen dhe dobësohen plotësisht; paaftësohen dhe nuk kanë mundësi për t'i përcjellë ngjarjet dhe rrethanat me të tjerët.

Kur ndjenjat pasojnë imoralitetin, e ngopen me dhé, mbushet me të, dhe përzihen me shpirtin, vështirë është për t'u larguar prej saj, edhe pse njeriu arrin shkallën më të lartë të zhvillimit.

Për këtë arsye devotshmëria në rini është më e dashur se devotshmëria në pleqëri. Në shumicën e rasteve, shumicën e brengave njerëzit nuk mund t'i mënjanojnë, për shkak se luftën e madhe dëshirojnë ta fitojnë me angazhim të vogël, ndërsa harrojnë se po që se lidhen fortë me fuqinë më të lartë të tyre, do të dilnin ngadhënjimtarë dhe do të çliroheshin nga vështirësitë e tyre, pa mund dhe lodhje dhe për një afat shumë të shkurtër.

Besimtari është fortifikatë e fortë, lidhje e fortë, të cilën e forcon gjithmonë, dhe kudo që shkon e vjen, e di se Allahu është me të, dhe se praktikimi i planprogramit ti siguron qetësi shpirtërore, fizike dhe psikike. Allahu i mbron ata të cilët i besojnë Atij dhe se Imani i fortë është arma me të cilën tejkalohet çdo pengesë, të cilën historia as që mund ta ketë parë asnjëherë, pos në historinë Islame, posaçërisht para njerëzve mizor dhe kriminelë me pozita të larta, siç ka qenë rasti i Haxhaxh Ibn Jusuf Eth-Thekafiju, i cili ka qenë i rreptë, mizor dhe agresiv.

Një ditë prej ditëve e pyet një njeri prej Havarixhëve: “A e ke tubuar (mbajtur në kokë) Kur’anin”? - Ai i është përgjigjur: Pse, a mos ka qenë i shpërndarë, e unë ta tuboj! - E Haxhaxhi e pyet atë: “A e lexon ti përmendësh”? Ai i përgjigjet: përkundrazi, unë e lexoj duke e shikuar. - Ai prapë e pyet: “A e di përmendësh (a e ke ruajtur në mendje)””? Ai i përgjigjet: Pse, a mos po frikësohesh se ai ikë (humb), e unë ta ruaj. - Ai e pyet: “Çka mendon për emirin e besimtarëve, Abdul Melikun”? Ai ia kthen: Allahu e mallkoftë atë me gjithë ty! - Ai i thotë: “Tash do të të mbys, e si do ta takosh Allahun”!? E takoj me veprën time, ndërsa ti do ta takosh me gjakun tim!

Kjo ka qenë trimëri e vërtetë, ndaj kriminalitetit të vërtetë të Haxhaxhit, që para mizorisë së tij nuk ka pasur frikë dhe dorëzim, por sqarim dhe guxim, sepse ajo ka qenë forcë e vërtetë, e jo formale apo false. Kështu çdo i drejtë nuk frikësohet, e as nuk trembet dhe nuk përgjigjet ndryshe, pos me dituri, drejtësi dhe bindje të sigurt.

Le ta dijë njeriu, se e kaluara para njeriut mbetet dhe shpërblimi i durimtarëve, të cilët durojnë kur i godet diçka është i madh dhe begati për të.

E tërë jeta është sprovë: edhe e mira edhe e keqja janë sprovë; edhe pasuria edhe varfëria janë sprovë; edhe shëndeti edhe sëmundja janë sprovë. Njeriu sprovohet me të mirë për tu vërtetuar se a është falënderues, ndërsa tjetri sprovohet me të keqe, për ta shikuar se a po mohon apo është durimtar.

Atë që Allahu e tubon, njeriu nuk mund ta ndajë. HIDE dhe TESHENUXH është alegori për injorancën. I urti për injorantin me përbuzje ka thënë: Merr vendim të prerë pa ditur fare, hidhërohet para se të kuptojë. Po ashtu unë mendoj se prej cilësive kryesore të injorantit është se ai ngarkohet pa kurrfarë shkakut dhe nënçmon pa kurrfarë arsye.

Te Allahu i poshtëruar në këtë dunja është ai, i cili zhytet në të, ndërsa nuk arrin mirësi pa u larguar prej saj.

Për këtë arsye, mendoj se e mira do të jetë gjithmonë deri në Ditën e Kijametit, e mira në shpirta dhe në ekzistencë harmonizohet në shumë çështje të jetës.

Poeti Shevki, Zoti e mëshiroftë, ka thënë:

Kur dunjaja e zë vendin e së mirës, e ajo falënderohet, atëherë poshtërsia del në shesh. Mirëpo, qëllimi dhe dëshira jonë është që të përhapet e mira në zemra. Sepse jam i pikëlluar për ta dhe ardhmërinë e tyre, aq sa kemi pasur mundësi dhe për t'i zgjedhur dhe për t'i tubuar, e cilës prej tyre duhet dhënë përparësi. Sepse shumë mendime të cilat na kanë ardhur kanë qenë të pakuptueshme dhe të paargumentuara. Parim e kemi pasur atë se gjithmonë Allahu është me ne dhe që gjithmonë Ai të jetë i kënaqur me ne, dhe Ai të na udhëheqë, duke u bazuar me lutjet e sinqerta të shokëve tanë të sinqertë, prej dijetarëve të cilët e kanë preokupim thirrjen islame, me metodologji të shëndoshë, dhe me vendosmëri, pa neglizhencë, as artificialisht dhe larg komplikimeve dhe ekstremitetit.

Mjeku e rren pacientin duke mos ia treguar rrezikshmërinë e sëmundjes, që të mos mashtrohet në jetë dhe të mos e mashtrojë jeta, sepse realiteti dhe e vërteta në këto qëndrime dhe jo në këto vende nuk e di se rrena mund të jetë e mirë apo e lavdërua. E vërteta jo në këto fusha nuk ka nevojë tjetër, përpos bindje dhe sinqeritet.

Dhembjet e forta janë më të vështira se vdekja, më të ashpra, dhe më të dëmshme, p.sh. thellësia e dhembjeve është më e fuqishme se vetë dhembja.

Mjeku patjetër duhet pasur parasysh këtë që dhembjet e sëmundjes mos t'i bëjë më të dëmshme se sa janë.

O Zot, mos na bën prej konfrontuesve, na lehtëso rrugën për te Ti, me ndihmën Tënde, dhe na largo injorancën dhe lajthitjen. Na bën zemrat të sinqerta, të pastra.

Edhe pse armiqtë tanë janë rrenacak, pa kurrfarë arsye, fali ata, udhëzoji edhe pse kanë arsyetime. Na fal neve dhe fali ata, dhe na bën që të jemi të kuptueshëm edhe ne edhe ata.

Çka është e dëmshme na shpëto prej saj dhe çka është e dëmshme prej neve shpëtoji ata. Çka posedojmë prej të mirave: sinqeritetin, besnikërinë na bashko dhe na afro nëpërmjet tyre që ta ngritim lartë të vërtetën dhe fenë, larg nga ekstremiteti dhe mbrona nga lajthitjet dhe gabimet, sepse feja jonë është e qartë, është thirrje me urtësi dhe me këshilla të mira, dhe diskutim në çështje të mira dhe të dobishme.

Allahu çoftë i kënaqur. Falënderoj Allahun, Zotin e gjithë botëve.

*Kajro, 11 Dhulkade, 1401 h.
9 Shtator, 1981. Isa a.s. Sejid Xhemil*

HAXHI PARA ISLAMIT

Pyetje: A ka ekzistua Haxhi para Islamit, dhe forma a ka qenë e tillë siç e kryejmë sot?

Imami i nderuar Shaëraviju përgjigjet:

Shihet qartë në tregimin e Ibrahimit a.s. me Qaben në ajetin kur'anor:

“Dhe thirr njerëzit për haxh, do të vijnë në këmbë”. Urdhri i Ibrahimit është i qartë se ka bërë thirrje për haxh, e Ibrahimit e ka krye praktikisht. Kjo është e vërtetë. Mirëpo nëse dëshirojmë që fjalën e Zotit me kuptua në thellësi kuptojmë se: Allahu e ka urdhërua Ibrahimin me ngrit themelet, e domethënia e ngritjes së themeleve është se Qabja ka ekzistua më herët, ndërsa Allahu ka urdhërua që të ringritet. Ringritje do të thotë se hapësira ka ekzistua, themelet kanë ekzistua, konstruksioni ka ekzistua pasi që edhe në ajet tjetër Zoti i Lartmadhëruar në mënyrë të përgjithshme e ka tregu “Nuk ka dyshim se shtëpia e parë e cila është ndërtua për njerëzit, është ajo në Meke, e cila është e bukur dhe udhëzim për njerëzimin”. Pasi që veç ka qenë e paraparë dhe e vendosur për njerëzimin, prej se ka ekzistua njerëzimi, dhe përderisa ka qenë Qabja, ka ekzistua haxhi.

Ai i cili thotë se haxhi është prej Ibrahimit a.s. dhe se Qabja është prej Ibrahimit a.s. nuk është e vërtetë, por e vërteta është se Qabja ka ekzistua edhe më herët se Ibrahimit a.s., por edhe haxhi ka ekzistua më herët se Ibrahimit a.s.

Pse? Sepse është e mundur që Qabja është rrënuar, prej ndonjë shkak prej shkaqeve, ndërsa Allahu ka dashur ta qes në sipërfaqe prapë këtu çështje, dhe pasi që Ibrahimit a.s. e ka rindërtua, prapë ka bërë thirrje për haxh. Për të treguar rindërtimin konkret të Qabës, dhe riprogramimin e haxhit si obligim. Allahu ka dashur me i rikthye themelet e Qabës për me krye haxhin njerëzit. Sepse Ibrahimit a.s. i ka ndihmua Ismaili me i ringrit themelet “Dhe përkujto kur Ibrahimit i ka ngritë themelet e Qabës me Ismailin”. Nga kjo kuptohet se Ismaili ka arritur moshën e pjekurisë, gjë që i lejohet atij me i ndihmua babës së tij me i ringritur themelet e Qabës.

Kur'anit na tregon se Ibrahimit a.s. e ka dërgua dhe e ka vendosur për me jetua Ismailin dhe nënën e tij të shtëpia e Shenjtë (Qabja). Kjo dëshmon se shtëpia ka ekzistua edhe para se me shkua Ibrahimit aty.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe ne ia përgatitem Ibrahimit për me shkua te vendi i shtëpisë së shenjtë (Qabes)”.

Pra Qabja ka ekzistua në atë kohë dhe para asaj kohe, por në atë kohë nuk ka qenë e banuar, por prapë është banuar (është bërë vendbanim) dhe është përkufizuar.

UMREJA A ËSHTË SUNET APO FARZ?

Pyetje: Umreja a është sunet apo farz?

Shejh Shaëraviju përgjigjet: “Thënia e Zotit të Lartmadhëruar”, do të thotë se Umreja është farz e jo sunet. Përderisa Zoti i Lartmadhëruar haxhin e ka cilësua se është “më i madhi”, që do të thotë se ka edhe “haxh të madh”.

Ndërsa “haxhi në Qabë për atë i cili ka mundësi dhe e ka rrugën e lirë” ka për qëllim haxhin dhe Umren së bashku.

Po ashtu mund të kuptojmë se Zoti i Lartmadhëruar e ka cilësua haxhin në Arafat se është haxhi më i madhi, ndërsa haxhi në të cilën nuk është qëndrimi në Arafat nuk është “haxhi më i madhi” por “haxhi i madh”, po mos të ishte kështu do të zbehej domethënia.

Në hadithin “Është ndërtua Islami në pesë shtylla”, ka për qëllim haxhin dhe Umren së bashku.

HAXHI PËR TJETRIN

A mund ta kryej femra për nënën e saj?

Një grua e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Vërtetë nëna ime ka vdekur dhe nuk e ka krye haxhin. Ata kryej haxhin për të? Është përgjigj: Po kryeje haxhin për ta.

HADITHI SAHIHË

Një njeri derisa ishte afër të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. dhe thoshte: “Leb-bejke an Shebremete”. Kur e ka dëgjua i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: A e ke krye haxhin për vete? Ai i thotë jo!. Muhamedi a.s. pastaj i ka thënë: Kryeje haxhin për vete, e pastaj për Shebremetën.

E KA REXHISTRU SHAFIJU DHE
AHMEDI

KONTAKTIMI SEKSUAL NGA PRAPA

Një grua e Ensarëve e ka pyetur Muhamedin a.s. për “TEXHBIJËN” për kontaktimin seksual prej nga prapa por jo në anus por në vagjinë.

Përgjigje: Ia ka lexuar asaj ajetin Kur’anor: “Gratë e juaja janë arat (bahçet) e juaja dhe kontaktoni në arat e juaja nga të doni (por në vagjinë).

E KA REGJISTRUAR AHMEDI

Omeri r.a. i ka thënë Muhamedit s.a.v.s.: O i dërguari i Allahut: Jam shkatërruar. Muhamedi a.s. i ka thënë: Po si je shkatërruar? I ka thënë: Bashkëshortja ime është rrotullua dhe skam pasur çka të bëj: pastaj ka zbritur ajeti Kur’anor: **“Gratë e juaja janë arat e juaja dhe kontaktoni në arat e juaja nga të doni”**. Kontakto nga para e nga prapa, vetëm mos kontakto kur ajo është në kohën e menstruacionit dhe në anus.

E KA REGJISTRUAR AHMEDI DHE
TIRMIDHIU

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka lejua kontaktimin seksual nga prapa por jo në anus. Muhamedi a.s. ka thënë: “Të mallkuar janë atë që kontaktojnë me gratë e tyre në anus”.

Po ashtu ka thënë: Kush kontakton me gruan me menstruacion ose në anus ose i beson falltarit, ai ka mohu atë çka i ka zbritur Muhamedit.

KËTO HADITHE JANË TË REGJISTRUARA NË MUSNEDIN E
AHMEDIT

FILLIMI I SHPALLJES

Si i ka zbritur Vahji të Dërguarit të Allahut Muhamedit s.a.v.s.?

Shejh Shaëraviju përgjigjet: Që në fillim të shpalljes Pejgamberi s.a.v.s. ka pas angazhim dhe përpjekje tepër të madhe, dhe pas shpalljes së ajeteve të para ka thënë: Më mbuloni. Më mbuloni. Pra ky ka qenë kontakti i parë në pranimin e shpalljes dhe është mbulua pasi që veç ka pasur vështirësi. Është vërtetua në biografi të Muhamedit a.s. se fytyra e tij u mbushte me djersë. E gjithë kjo ka qenë dukuria në trup. Kjo dukuri në trup

tregon se ka pasur vështirësi fizike, mirëpo përderisa ka pasur vështirësi fizike, patjetër ka pasur siç kemi përmendur më parë edhe ndryshimi kimik në vet trupin njerëzor të Muhamedit a.s. Sepse forca më e madhe (Meleku) takohet me njeriun. Dhe është e pamundur pa qenë të paraqitura dy çështje:

Çështja e parë: Ose Meleku prej qenies së tij melek me kalua në qenien njerëzore, pra me u barazua me qenien njeri si Muhamedi a.s. dhe të flet me të. Mirëpo në atë rast nuk ka për njeriun ndonjë vështirësi me pranua shpalljen, sepse procesi fillon prej Melekut, e ai paraqitet si njeri dhe i flet ndërsa Muhamedi mbetet në natyrshmërinë e tij-njeri. Ose te Muhamedi a.s. me u paraqit diçka e jashtëzakonshme që Muhamedi a.s. të tronditet dhe natyrshmëria e tij të përqendrohet në pranimin prej një force më të madhe, pra prej Melekut. Kjo mënyrë është mënyra më e vështira, mirëpo ai është përqendrua fortë dhe e ka pran me përpikëri dhe e ka përcjell me përpikëri atë çka i ka zbritur prej Allahut, sepse Meleku kur të shndërrohet njeri është e mundur që të mendohet se prapë ai është në një shkallë më të lartë se shkalla njerëzore më drejtohet, më flet dhe e tregon këtë, ndërsa ta Muhamedi s.a.v.s. nuk ka më kontakt të jashtëm. Ose me ndodh diçka e jashtëzakonshme ku Muhamedi a.s. dridhet, djersitet dhe i ndodh ajo çka i ka ndodh. Kjo është çka mënyra e sjell atë gjendje. Dhe kur të vjen dituria nëpërmjet kësaj rruge, e di se ajo dituri ka ardhur nëpërmjet rrugës së jashtëzakonshme, e kupton qartë se çka i ka zbritur Muhamedit s.a.v.s. dhe për këtë ai ka argument, se ajo ka qenë çështje e jashtëzakonshme as njeri, as të folur pas perdeje.

BOTA TJETËR DHE KJO BOTË

Çfarë kuptimi ka ajeti “Dhe bota tjetër, është më e mirë për ty se kjo botë” Sadakallahul Adhijm.

Përgjigje: Për këtë ajet të suretul “Duha” disa mendojnë se “Bota tjetër” është për qëllim jeta e botës tjetër. Mirëpo Shejh Shaëraviju sqaron se kjo fjalë “Bota tjetër” ka për qëllim zbritja e shpirtit besnik, xhibrilit me shpallje “herën e fundit”.

Imami i mirënjohur thotë: Për këtë arsye i Dërguari i Allahut s.a.v.s. asnjëherë nuk është ankuar për shpalljen. Shtrohet pyetje: Pse? Sepse është frymëzua është edukua me edukatën e fuqisë për pranimin e çështjeve të vështira, dhe vështirësia është lehtësua, dhe qenia e tij njerëzore as që e ndien. Kur të vjen njeriu dhe ia paraqet njeriut një çështje të vështirë, e kur ta sheh se fryti i asaj çështjeje të vështirë është i ëmbël, pasi që ti pushon, i largohet lodhja ndërsa i mbetet ëmbëlsira e asaj çka i ka zbritur. Ëmbëlsira e shpalljes për të cilën përmalohet nëse nuk i zbret prapë. E kur të përmalohet, atëherë i tubohet forcë e madhe për pranin sa që nuk e ndien kurrfarë lodhje herëve tjera.

FEMRA E MARTUAR DY HERË ME CILIN BURRË DO TË JETË NE XHENET

Një femër e cila është martuar dy apo tri herë me cilin do të jetë në ditën e kijametit?

Me këtë është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe është përgjigj:

Ajo do të zgjedh, dhe do ta ketë atë, i cili ka qenë më i sjellshëm me të.

SUNDIMI DHE SUNDIMET

Pyetje: Cili është dallimi në mes të sundimit dhe sundimeve?

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Çoftë i lartësuar (Allahu), i Cili në dorë të Tij ka sundimet e çdo gjëje”.

Këtu është përdorur fjala “sundimeve” në shumicë dhe nuk është përdorur fjala “sundim” në njëjës.

Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“I Allahut është sundimi i qiejve dhe i tokës”.

Këtu është përdorur fjala “sundim” në njëjës dhe nuk është përdorur “sundimet” në shumës. Kjo nga arsyeja se “sundim” është atë që e dëshmon dhe e sheh, ndërsa “sundimet” janë çështjet e fshehta dhe sekrete. Në rend të parë tregohen çështjet e dukshme, ndërsa nuk mund të dish çka ka pas çështjeve të dukshme.

Nuk ka dyshim se hapësirat dhe çështjet pas çështjeve të dukshme është bota e sundimeve.

“Çoftë i Lartësuar Allahu, i Cili në dorën e Tij, janë sundimet e çdo gjëje dhe te A do të kthehen (që të gjitha)”.

NËSE RROBA NDOTET ME GJAKUN E MENSTRUACIONIT

Një grua e ka pyetur Muhamedin s.a.v.s.: Nëse ndonjëherë prej nesh e përlyen rrobën me gjakun e menstruacionit, si duhet vepruar?

Përgjigje: Muhamedi s.a.v.s. është përgjigjur: E shkund, pastaj e fërkon duke e spërkatur me ujë, pastaj e pastron dhe në fund falesh me të.

AFATI I LEHONISË (NIFASËS)

Sa është kohëzgjatja e lehonisë?

Transmeton Darukutni se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: Pas lindjes, femrës i vazhdon lehonia 40 ditë vetëm nëse e vëren dhe e vërteton pastërtinë para kësaj kohe.

POLEMIKA DHE ARGUMENTIMI NË EKZISTIMIN E ZOTIT

Allahu i Lartmadhëruar ka ekzistua para ekzistencës, atëherë kur nuk ka pasur asgjë pos Tij, ashtu siç është regjistruar në hadithi në Musnedin e Imam Ahmedit. Ekzistimi i Zotit të Lartmadhëruar është i vazhdueshëm dhe nuk ka mbarim dhe njeriu as që mund të ketë mundësi ta përkufizojë mënyrën e ekzistimit të Zotit pa fillim dhe pa mbarim.

Atëherë për çka bëhet polemika? Polemika bëhet rreth argumentimit për ekzistimin e Zotit apo rreth tentimit për vërtetimin e ekzistimit të Zotit?

Në lidhje me temën për ata që polemizojnë ekzistimin e Zotit apo mundohen të vendosin argumente për ekzistimin e Zotit, i nderuari Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju në rend të parë pyet: Çka është ajo që të ka shtyrë në këtë, të ka lodhur ty, e ka lodhur mendjen dhe logjikën tënde për të sjellë argument për ekzistimin e Zotit.

Shejhu na zbulon një sekret shumë të rëndësishëm në lidhje me këtë kur thotë: Allahu ekziston në vetveten tonë instinktivist dhe natyrshmërisht. Ai ekziston në tërë jetën e qenies tonë. Ai i cili tenton të sjellë argument mbi ekzistimin e Allahut, në të vërtetë ai veç e ka vërtetuar ekzistimin Allahut, pa pasur nevojë për argument.

Argument për ekzistimin e Allahut, sepse kërkesa e argumentit dhe angazhimi i mendjes në të, do të thotë se Allahu ekziston në ne natyrshëmrisht, e ndiejmë dhe e përjetojmë dhe e dimë se ekziston. Sepse ekzistimi i Allahut qenka para tentimit për të gjetur argument. Ky tentim është prezent dhe do të jetë prezent deri sa të ekzistojë jeta. Vërtet ky është një apelim se Zoti ekziston, ndërsa ne tentojmë dhe përdorim atë çka mendjes i përshtatet për të gjetur argumente.

SHENJA E PARË E KIJAMETIT

Cila është shenja e parë e kiametit?

Shenja e parë e kiametit është shpërndarja e zjarrit prej lindjes e deri në perëndim. Kjo është një çështje prej tri çështjeve të cilat i ka tregua Abdullah Ibn Selam.

**KJO ËSHTË E TREGUAR NË SABIHUN E
BUHARIUT**

MREKULLIA E ISRASË DHE MIËRAXHIT

Mrekullia e Israsë dhe miëraxhit është prej mrekullive shumë interesante të islamit e cila ka sjell argumente dhe fakte të fuqishme për me i befasua kokat e pabesimtarëve dhe hipokritëve. Çfarë komenti jep Shaëraviju në lidhje me këtë mrekulli.

Imami i nderuar thotë:

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka bërë Isranë pastaj është ngritur në qiellin e shtatë në Sidretul Munteha me fuqinë e Allahut ndërsa ne në ditën e Kijametit ku do të jemi me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar.

Ma mos të ishte ajeti Kur'anor "Ju nuk mund të ngriheni" vetëm se me fuqinë e (Allahut) disa njerëz nuk kishin me pranua Isranë dhe Miëraxhin, po pasi që ky ajet ka zbritur kjo do të thotë se Zoti i Lartmadhëruar me fuqinë e tij e bën kë të dojë të ngrihet në qiell dhe ashtu qysh e përcakton ai.

Nëse e dëgjojmë ndonjërin duke thënë: njeriu është ngritë në hapësira të qiellzave dhe të tokës, pasi që ai ka hypë në hënë. Ne i themi atij se njeriu është ngritë në lartësi prej milionave vit drite vetëm për disa sekonda ndërsa hëna është vetëm një largësi e vogël e qiellit të parë të botës, dhe duket që prej miliona vite drite të hiqen dy sekonda për të arritur në largësinë e thellë e cila është prej qiellit të kësaj bote. Dhe ende nuk ka arrit as në qiellin e parë.

Vazhdon Shejh Shaëraviju e thotë:

Kjo është një çështje shumë e rëndësishme për me iu kundërpërgjigj atyre që tentojnë të thonë se Kur'anor është libër njeriu, e e harrojnë fuqinë e Allahut, dhe mundohen me të arritura të vogla që edhe ata vet e kuptojnë se askund ende nuk janë ngritur, sepse unë kur bëj analizë se për disa sekonda kalohen miliona vit drite, nuk mund të them, apo njeriu i logjikshëm nuk mund të thotë se është ngritë në lartësi të qiellit të tokës prej miliona vite drite.

Për këtë arsye, muëxhizja e Israsë dhe Miëraxhit është e përgjithmonshme, dhe do të mbetet deri në ditën e kiametit, dhe njeriu nuk mund të arrij pa marr parasysh në Çfarëë niveli të diturisë dhe fuqisë të arrijë për me u ngritë në hapësirat e qiellërave dhe tokës. Ai

nuk mund të ngritet as në qiellin e botës e mos të flasim në shtatë qiejt. Mrekullia e Miëraxhit do të mbetet mrekulli e cila i fton njerëzit në besimin në Allahun, në fuqinë e tij, mrekulli e cila meriton adhurimin në një Zot.

MARTESA DHE SHKURORËZIMI

Pas martesës së vështirë, me problemet në të, me vështirësitë dhe pamundësia bashkëshortore, ne shohim se shkurorëzimi është ilaçi më i lehti për të zgjedh problemin e padurimit të ndërsjelltë në familje dhe shoqëri.

Çka mendon cili është shkak i cili shpie deri aty?

Kjo ndodh për shkak të konfliktit të bashkëshortorëve duke mos e përfillë dhe duke mos e shikuar atë që e kërkon dhe parasheh Islami në të gjitha çështjet. Po nëse kërkuesi i martesës do të martohej ashtu siç e parasheh dhe e kërkon Allahu, nuk do të ndodhte ajo që shpie në shkurorëzim.

NË MES TË SHTIMIT DHE TË PAKËSIMIT

Të gjitha sendet rriten, shtohen, por edhe zvogëlohen e humben. Ndryshim i shpejtë dhe i përnjëhershëm nuk mund të ndodhë. Kjo është mëshira e Allahut ndaj njerëzimit dhe ndaj krijesave në përgjithësi, sepse ndryshimet e menjëhershme lënë pasoja të pashërueshme në shpirtrat gjë që shkakton pengesa në jetën, e cila vazhdimisht është e ndryshueshme.

Pasi që ditët ndryshojnë dhe jeta nuk është stabile, kanoset rreziku që befasisht gjërat të kalojnë prej një gjendje në një gjendje tjetër, por ndryshimi i asaj gjendje patjetër duhet të bëhet në mënyrë graduale dhe ngadalë-ngadalë.

Kur ia parashtrova këtë çështje Imamit, Shejh Shaëravijut, ai tha: “Sasia e shtimit dhe sasia e pakësimit është çështje e cila ndodhë në çdo pjesë të kohës. Në syrin e nënës foshnja nuk rritet përnjëherë. Mirëpo p.sh., pas kalimit të dy muajve dhe pas një krahasimi e sheh se është rritur në njëfarë mase. Kjo është peshoja e krahasimit me jetën, diçka çka është e ndryshueshme me diçka që është përmbajtjesore, e domosdoshme – statike.

Siç thonë dijetarët për çështjen e evolucionit se njeriu e ka prejardhjen prej majmunit, ne u kundërpërgjigjemi: Pse atëherë çdo majmun nuk është shndërruar në njeri, mirëpo majmunët prapë kanë mbetur në gjendjen e tyre të mëparshme.

Çdo herë kur femrës i zbehet bukuria e saj, i kompensohet bukuria në bukuri tjetër. Shtimi dhe pakësimi në shumicën e çështjeve ndodhin në atë masë siç e kërkon jeta. Vazhdimësia e jetës dhe barazia apo paralelizmi i saj vetë e kërkon pakësimin në një çështje prej shumë çështjeve.

NDJENJAT E BRENDSHME

Pyetje: Sa i përket mosmarrëveshjes dhe problemeve që shpërthejnë mes burrit dhe gruas, pa marrë parasysh shkakun, cila procedurë është më e mira dhe më e shëndosha, për t'i tejkaluar vështirësitë bashkëshortore.

Përgjigje: Shejh Shaëraviju në lidhje me zgjidhjen e këtij problemi këshillon dhe parasheh shërimin shpirtëror medicinal, i cili është i dobishëm në të cilin janë ilaçet shëruese me ndihmën e Allahut.

I nderuari Shejh Shaëraviju thotë: Çdo konflikt, i cili ndodh në mes burrit dhe gruas, nëse ai konflikt vjen nga faktorët e jashtëm, vështirë është që të shërohet, ndërsa nëse nuk janë faktorët e jashtëm shkak i atyre mosmarrëveshjeve, atëherë me kalimin e kohës, dhe atë të një kohe të shkurtër, i zgjedhin ndjenjat e brendshme.

Shejhu i mirënjohur vërteton se harmonizimi familjar në mes të burrit dhe gruas janë garancioni më i sigurt për zgjidhjen e problemeve shoqërore dhe sigurinë shoqërore.

MAGJIA E POPULLIT TË FIRAUNIT DHE SHKOPI I MUSASË A.S.

Populli i Musasë a.s. është i njohur për magji. Musa a.s. ka qenë dashtë patjetër t'i mposhtë ata, për t'u vërtetuar e vërteta e misionit dhe peygamberllëkut të tij, e vërteta e ftesës së tij dhe e dërgimit të tij se është i dërguar prej Allahut të Lartmadhëruar, për të transmetuar shpalljen prej tij.

Prej vështirësive më të mëdha është që të dërgohet i Dërguar te magjistaret dhe shizofrenët, të cilët e kanë profesion magjinë dhe janë marrë një kohë të gjatë me atë veprimtari negative. Dhe ka qenë dashtë të jetë i përgatitur shumë, më shumë se ata, që ata të jenë të detyruar të dorëzohen të nënçmuar dhe kokulur.

Magjistari nuk dorëzohet, përpos ndaj atij i cili është më i madh se ai, sikurse mjeku kur të dëshirojë ta mjekon veten e tij, ai ndryshon prej mjekut i cili është më i specializuar se ai dhe më me përvojë. Jo është ajo çka ka ndodhur me Musanë a.s. kur Allahu e ka aftësuar, e ka përsosur, pastaj atë eksperiencë e ka vendosur në praktikë dhe i ka mbyllur gjuhët e të pavërtetëve me gjuhën e sinqertë dhe të vërtetë, dhe përvojën dhe eksperiencën e drejtë.

Pyetja është: Cili është dallimi në mes të magjisë së popullit të Musasë dhe shkopit të Musasë a.s.?

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Çka ke ti në dorën tënde të djathtë o Musa? Musa a.s. ia kthen: Ky është shkopi mbi të cilin mbështetem, me të e ngas bagëtinë time dhe ky është shkopi im që e përdori për punë tjera”.

Këtu Zoti i Lartmadhëruar ka dëshiruar që ta bëjë provën gjenerale të Musa a.s. kur i thotë: “Hidhe atë o Musa”.

Musa a.s. e hodhi shkopin. Kur ai shkop menjëherë është shndërruar në gjarpër aktiv. Musa a.s. është frikësuar. Mirëpo Allahu i thotë: Mos u friko, se ne prapë do ta rikthejnë në gjendjen e tij të më parme.

Po të mos ishte frikësuar Musa, ne do të kishim thënë se ka qenë lloj magjie. Për këtë arsye duhet ta tërheqim vërejtjen se ka dallim të madh në mes të magjisë së popullit të Firaunit dhe asaj çka iu është dhënë Musasë a.s..

Kur'ani përshkruan gjendjen e Musasë a.s.:

“Dhe filloi që të rrëqethet dhe të frikohet në vetvete”.

Ky është argument se shkopi i Musa a.s. është shndërruar në gjarpër të vërtetë dhe ka qenë gjarpër në kuptimin e fjalës, që do të thotë se shkopi në të vërtetë e ka ndryshuar lëndën e tij, e ky është ai dallimi në mes të magjisë së popullit të Firaunit dhe shkopit të Musasë.

Vërtet magjia e Firaunit vetëm i ka hipnotizuar sytë e njerëzve të cilët pastaj nuk kanë mundur ta vërejnë realitetin e sendeve, mirëpo ata kanë parë iluzion, pra janë magjepsur sytë e tyre.

Ndërsa Muëxhizja e Musasë – shkopi, e ka ndryshuar esencën dhe është shndërruar në gjarpër të vërtetë. Kështu ne shohim Muëxhizen e Allahut, të cilën ia ka dhënë Musasë, e cila është realizuar pas testimit, e pas testimi e ka obliguar për kryerjen e rolit të shkopit.

Kështu na mëson Allahu, se nuk ka detyrë vetëm pas testimit dhe nuk ka sukses të mirëfilltë pa ushtrimin të vazhdueshëm dhe përsosmëri.

ÇIFTËZIMI DHE GJITHËSIA

Në suretu Ja Sinë Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Çoftë i Lartësuar Ai i cili ka krijuar gjithçka qift, prej asaj që mbinë prej toke, edhe në vetveten e tyre edhe në ato (gjëra) të cilat nuk i dinë”.

Cili është argumenti shkencorë i pjesës së ajetit “dhe në ato (gjëra) që nuk i dinë”?

Përgjigje: I nderuari Shejh Shaëraviju në lidhje me komentim të këtij ajeti fisnik thotë: Çiftëzimi është te të gjitha krijesat, të gjithë e dimë se e jemi qift dhe martohemi, e dimë në gjallesa, e dimë edhe në bimë. Mirëpo thënia e Zotit të Lartmadhëruar “dhe në atë çka nuk dinë”.

Kjo është argument se ky proces është gjithëpërfshirës në tërë ekzistencën, se po të ishte ndryshe, atëherë si të interpretohet pjesa e ajetit “dhe në atë çka nuk dinë”. Çka na jep të kuptojmë ky ajet?

Ky ajet bën që të kuptojmë se Zoti i Lartmadhëruar e ka ngritur dhe e ka fisnikëruar mendjen dhe logjikën bashkëkohore në atë se po të kishte thënë shkenca për çiftëzimin e disa çështjeve mendja do të ishte hamundur dhe nuk do ta kishte pranuar. Mirëpo thënia e Zotit të Lartmadhëruar “dhe në ato (gjëra) të cilat nuk i dini”, që kur pastaj do të zhvillohet mendja jote dhe shkenca, do ta mësosh dhe do ta kuptosh se çështja e çiftëzimit është prezent në tërë ekzistencën. Tash e kanë vërtetuar në shumë çështje, e kanë vërtetuar në atom, e kanë vërtetuar në fushën magnetike – pozitivin dhe negativin. Nuk na ka mbetur sot asgjë tjetër, pos t’i drejtohem Zotit të Lartmadhëruar me lutjen “SUBHANE”, se askush nuk ka mundësi për asgjë përpos Tij. Çoftë i Lartësuar Ai në dorën e të Cilit janë sundimet e çdo gjëje.

PSE NAMAZI HAPTAZI DHE FSHEHTAZI

Dëshirojmë ta dimë sekretin pse në namazin e drekës dhe të ikindisë Kur’ani lexohet fshehtazi ndërsa në namazin e sabahut, të akshamit dhe të jacisë Kur’ani lexohet me zë.

Imami i mirënjohur Shejh Shaëraviju thotë:

Sekreti qëndron në atë se muslimanët në fillim të Islamit kanë qenë të dobët dhe Kur’anin e lexonin me zë në namaz në kohën kur armiqtë e tyre flinin në shtëpitë e tyre në sabah dhe këndonin me zë në aksham dhe në jaci, sepse pabesimtarë ishin në gjumin e natës, ndërsa këndonin Kur’anin pa zë në namaz të drekës dhe të ikindisë sepse armiqtë ishin zgjuar dhe ishin të shpërndarë ditën në çdo vend. Ndërsa kur u forcua dhe me

muslimanët nuk ishin të dobët, prapë mbeten namazet fshehtazi, fshehtazi dhe namazet haptazi, pa e ndryshua gjendjen e mëparshme.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: Dhe mos këndo vetëm me zë në namaz, e as mos këndo vetëm fshehtazi në të, por kërko dhe përcjelle rrugën mes të djave-mesatare. E kjo do të thotë se falësi në namazin e tij duhet të këndo edhe fshehtazi por edhe haptazi, pra duhet ta gjej rrugën mesatare.

KU ËSHTË SHKURORËZIMI I TRETË

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Shkurorëzimi dy herë, e pastaj ose le ta mbajë me mirësi, ose le ta lirojë (shkurorëzojë) me mirësi.

Këtu qartë e kuptojmë se ka të bëjë me shkurorëzimin sepse Zoti i Lartmadhëruar pastaj thotë: Dhe burrat e tyre kanë prioritet për t'i kthyer ato. Ky është shkurorëzim me të drejtë kthimi, pse fjala “shkurorëzim” ka të bëjë me veprimin e burrit dhe është atribut për njëjës dhe për shumës.

Pasi që ajeti tregon “shkurorëzimi dy herë”, atëherë shtrohet pyetja: Ku është shkurorëzimi i tretë?

Përgjigje: Shkurorëzimi i tretë është në pjesën e ajetit ose le ta shkurorëzojë (lirojë) me mirësi, pra kjo tregon se kuptimi i fjalës “dy herë” është dy shkurorëzime, parafjala “f” tregon për pasimin e çështjes tjetër menjëherë. Pra ligjësimi i çështjes pason menjëherë çështja e njëjtë.

Ebu Davudi dhe Xhemaatun nga Ebi Reziym el Esedi transmetojnë se një njeri ka thënë: O i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: Unë po e dëgjoj se Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: “Shkurorëzimi është dy herë”. Po ku është shkurorëzimi i tretë? Është përgjigjur “ose shkurorëzimi (lirimi) me mirësi”. Kjo pjesë e ajetit pra tregon shkurorëzimin e tretë.

SHKURORËZIMI I TRIHERSHËM NË TË NJËJTËN KOHË

A lejohet shkurorëzimi i trefishtë në të njëjtën vend dhe në të njëjtën kohë: Transmeton Bejhekiu nga Ibn Abasi r.a. se ka thënë Ruhanete e ka shkurorëzua bashkëshorten e tij tri herë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, e pastaj është pikëlluar shumë. Kur i ka treguar të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. ka pyetur: Si e ka shkurorëzuar?

“E ka shkurorëzuar tri herë”.

Muhamedi s.a.v.s. në të njëjtën vend dhe në të njëjtën kohë: Tha Po!. Muhamedi a.s. i tha: Po kjo konsiderohet vetëm një shkurorëzim, si të duash, ke të drejtë të martohesh me ta, pastaj. Pastaj u martua me të shkurorëzuarën.

SUKSESI DHE LUMTURIA NË JETË

Pyetje: Çka do të thotë fjala sukses dhe lumturi në jetë?

Përgjigje: Imami i nderuar Shejh Shaëraviju thotë:

Kuptimi i fjalës “sukses në jetë” është që e tërë jeta të ketë sukses, e jo vetëm ti. Me rëndësi është që i tërë aktiviteti yt i jetës me qenë i suksesshëm. Një shoqëri, në të cilën

dominon apo e udhëheq dyfytyrësia dhe mashtrimi nuk mund ta quajmë sukses në jetën shoqërore. Sukses quhet kur tërë shoqëria është e suksesshme e jo vetëm individi.

Për me tregu më qartë: A të pëlqen ty me jetua në një rreth ku të gjithë ankohen, ka ankohet, ai ankohet. Pra ne ankohemi prej vetes sonë. Nëse secili në shoqëri ankohet, ta dish se ankohet edhe ankuesi edhe i ankuari.

Ndonjëherë njeriu e donë të keqen kur heshtë, pra e keqja patjetër duhet me u largu. Njerëzit mendojnë se sukcesi në jetë është kur vetëm ti ke arritur diçka, mirëpo esenciale është kur njeriu jeton, dhe të tjerët jetojnë pa u plasaritur mes vete, me qëllim që jeta e tij të jetë e sigurt. Nëse ai vet nuk është i fuqishëm mund të jetoj edhe pse është i dobët. Shoqëria e cila posedon hipokrizin, urrejtjen, egoizmin, dhe nëse ka plasaritje në mes të anëtarëve të saj, nëse ndonjëri është i fuqishëm ai u merr të drejtën e tjerëve me padrejtësi, po nëse është i dobët të tjerët ia marrin të drejtën me padrejtësi.

Njeriu i cili jeton, jetën pa u plasaritur me jetën e të tjerëve, ai është i lumtur në Çfarëdo forme. Mjafton që ata të cilët dëshirojnë që ta realizojnë suksesin e tyre në jetë me atë që e ka ndaluar feja, e ndalon Krijuesi, si me hipokrizi, rrenë, keqpërdorim dhe mashtrim. Mjafton vetëm ajo se edhe pse para tjerëve duken të mëdhenj në veten e tyre, me vetveten e tyre ata janë të vegjël, sepse njeriu, në rend të parë me veten e tij duhet me qenë njeri, që do të thotë mos me u largu prej natyrshmërisë dhe mos ta tradhtojë veten e tij. Unë mundem me e mashtrua tërë botën, por si ta mashtroj veten time se?

Pastaj Imami i nderuar shtonë:

Kur unë kërkoj prej ndonjë njeriu të dëshmojë para gjykatës rrejshëm, për dobinë time, me dëshminë e tij unë kam përfituar diçka, mirëpo vetë unë pastaj e urrej dhe në çdo moment dëshiroj ta largojë ose e mbajë të nënshtruar dhe të nënçmuar.

Pastaj në fund, çfarë sukcesi është i atyre të cilët korrin sukses në këso formash?! Ata kanë korrur sukses vetëm në fazën e parë të jetës (të kësaj bote). Mirëpo, jeta është e përgjithmonshme, e ata të cilët janë të drejtë dhe arrijnë sukses në përgjithësi, sepse Allahu u jep atyre të mira të përgjithmonshme, të cilat nuk ndërpriten asnjëherë.

TË SHKURORËZUARAT LE TË PRESIN TRI KOHËRA TË MENSTRUACIONEVE

Pyetje: Çka ka për qëllim fjala “pritje” dhe “kohëra” në pjesën e ajetit dhe cila është dispozita e ajetit për të?

Përgjigje: Në thënien e Zotit të Lartmadhëruar “Le të presin” është kallëzues, dhe ka për qëllim formën urdhërore në mënyrë alegorike.

Qëllimi për këtë që femrat ta kenë vëmendjen dhe le t’i presin sepse pjesëza **ب** - **B** është pjesëz transitive, që do të thotë se i urdhëruari duhet që të ngarkohet për të pritur, kjo është gjendje shpirtërore e mrekullueshme, sepse ato munden që të jenë ende tërheqëse për burrat e tyre, të cilët i kanë lëshuar. Ndërsa thënia e Zotit të Lartmadhëruar “tri kohëra” është kallëzues i ndajfoljes, sepse është shprehje për afatin-kohëzgjatjen “Mefuli bihi” është i anuluar, sepse fjala “pritje” është transitive. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe Ne ju presim ju, deri sa t’ju dënoj juve Allahu”. Le të presin për martesë, ndërsa anulimi sinjalizon se ato duhet që të mos martohen brenda këtij afati, por edhe të mos diskutojnë për martesë.

“Kuruë-kohëra” është shumës i “Kur-it- kohës” e ka kuptimin e menstruacionit.

(Transmetojnë Nesajju, Ebu Davudi, Darukutnij se Fatimeve bint Ebi Xhehsh ka thënë:

“O i Dërguar i Allahut, nëse femra është e papastër me ISTIHAD, a e len namazin që të mos e falë? Muhamedi s.a.v.s. i thotë: Jo. Le të mos e falë namazin vetëm gjatë menstruacionit”.

Po ashtu “Kur’ë” ka kuptimin e pastrimit, pra kohën e pastërtisë së gruas në mes të dy menstruacioneve.

ISLAMI ËSHTË SIMBOL, EMËR DHE CILËSI

Drita e Islamit ka depërtuar te të gjitha vendet e botës dhe do të jetë deri në Ditën e Kijametit.

Misioni i Islamit ka ardhur me planprogram të qëndrueshëm dhe stabil, i cili i siguron paqe dhe i sjellë të mira njerëzimit të në këtë botë dhe në botën tjetër. Fetë të cilat kanë qenë para Islamit bazën po ashtu dhe burimin e kanë pasur prej Islamit, mirëpo Islami në të cilin është dërguar i Dërguari i ynë s.a.v.s. i ka përfshirë të gjitha dhuntitë e Allahut.

Askush nuk mund ta mohojë se Islami ka ardhur mrekulli e çdo sukcesi të mendjes së njeriut, dhe sikur të zbriste para kohe, mendja dhe logjika vështirë e kishte pasur ta kuptojë, por ka ardhur në kohë të përshtatshme për ta zhvilluar logjikën dhe të kuptuarit. Nga këtu ka filluar të pranuarit dhe të kuptuarit e obligimeve.

Në Kur’anin fisnik qartë tregohet se fetë e mëparshme burimin e kanë pasur prej Islamit, dhe në tolerancën e tij, ndërsa ku pasur vetëm disa degëzime të cilat kanë qenë të natyrës së lehtë.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“A ishit ju (ithtarë të librit) dëshmitarë kur Jakubit iu afrua vdekja, e ai bijve të vet u tha: "Çka do të adhuroni pas meje"? Ata thanë: "Do ta adhurojmë Zotin tënd dhe Zotin e prindërve tuaj: Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, një të vetmin Zot dhe ne, vetëm Atij i jemi dorëzuar"!

(El-Bekare, 133)

“Ju (besimtarë) thuani: Ne i besuam All-llahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur”.

(El-Bekare, 136)

Parashtrohet pyetja: Si të dallojmë Islamin i cili ka qenë në fetë e përparme, dhe Islamin të cilin e ka zbritur Allahu vulë e feve të mëparshme, nëpërmjet më fisnikut dhe më të ndershmit, zotërisë tonë Muhamedit s.a.v.s.

Përgjigje: Imami i nderuar Shejhu Muhamed Muteveli Shaëraviju përgjigjet:

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Luftoni me një luftë të denjë për hir të All-llahut, se Ai ju zgjodhi ju (ju përcaktoi për të luftuar për rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fé me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai edhe më parë, e edhe ky (Kur'an) ju quajti myslimanë, e për të qenë i dërguari dëshmitar juaji dhe për të qenë ju dëshmitarë ndaj njerëzve, pra falni rregullisht namazin, jepni zeqatin, përmbahuni me All-llahun se Ai është ndihmëtari juaj. Sa mrojtës i mirë dhe sa ndihmëtarë i madh që është”.

(El-Haxh, 78)

Këtu teksti Kur’anor është i qartë dhe i definuar se Imani është i ndërlidhur me iradet, ndërsa ibadeti është i ndërlidhur me veprim. Puna e mirë kërkon përpjekje në

rrugën e Allahut të cilën Allahu e ka zgjedhur si besim për besimtarët, dhe nuk ka asgjë në fe që është vështirë për njeriun për ta kryer.

Islami është feja përfundimtare, ashtu siç ka qenë prej fillimit feja e parë. Ibrahim i a.s. është baba i besimtarëve.

Allahu veç e veç i quajtur besimtarët muslimanë, e ju jeni dhe keni qenë muslimanë në librat, të cilat kanë zbritur para Kur'anit, për t'i kënaqur dhe për t'i bërë të lumtur besimtarët në atë çka e ka ligjësuar (përcaktuar) Allahu më parë ka qenë ashtu siç Allahu ju ka quajtur muslimanë. Le të jetë përfundimi i islamit tuaj përsosmëri dhe kompletim i këtij islami, derisa i dërguari të dëshmojë për ju në Ditën e Kijametit, se ai ua ka transmetuar fenë, e ju keni vepruar atë që u ka mësuar dhe të jeni të lumtur edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër.

Kështu ne shohim se Allahu na ka quajtur neve muslimanë e nuk na ka cilësuar muslimanë, sepse për besimtarin islami është emër, cilësi dhe simbol.

Për këtë arsye është shumë e qartë se feja te Allahu është Islami, dhe emri Islam është cilësi e jona dhe simbol për ne, ndërsa sa i përket Islamit, për ata që kanë qenë para nesh ka qenë vetëm cilësi. Për këtë arsye, të gjitha fetë janë të cilësuar fe muslimane, ndërsa ne - pasuesit e Muhamedit a.s. jemi muslimanë me emër, me cilësi dhe me simbol; islami i ynë është superior.

PARAQITJA E BURRIT TË PARË

Zhduket burri në luftë, dhe nuk ka kurrfarë shenja të gjallërisë, pas një kohe gruaja martohet me një burrë tjetër dhe pasi që martohet, pas një kohe, befasisht paraqitet burri i saj i parë. Si duhet vepruar:

Kur iu është bërë kjo pyetje Shaëravijut është përgjigj: “Patjetër duhet të ngrihet aktpadia në gjyq”.

NUK DO TË ARRINI VETËM SE ME FUQI

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Thuaji (o Muhamed): po sikur të tuboheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë diçka të ngjashme sikur Kur'ani, nuk mund të sjellin të ngjashëm edhe sikur t'i ndihmonin njëri-tjetrit.

ISRA

Po ashtu thotë:

“O ju grup e xhinëve dhe e njerëzve nëse dëshironi t'i kaloni hapësirat e qiejve dhe tokës, atëherë kaloni, por jo, nuk mundeni përpos se me fuqi”.

ERR-RAHMAN

Këtu na del e qartë se fjala “insan” kur të vjen në një fjali me xhinët, Zoti i Lartmadhëruar e përdorë “insan”. Ku fjalën njeri (insan) e ve para fjalës xhin në ajetin e parë, mrekullia e kësaj është se fjala njeri, me fjalë njeriu është më i theksuari dhe më i njohur për ne se sa xhinët.

Pyetja e cila na parashtrohet neve është: Cili është kuptimi i fjalës së Zotit të Lartmadhëruar “Dhe ju nuk mund të ngriheni vetëm se me fuqi”. A është në pyetje fuqia absolute e Allahut apo mos është në pyetje “fuqia e diturisë” apo çka?

Imami i nderuar Shejh Shaëraviju thotë: Disa mendojnë se fjala sulltan ka për qëllim fuqinë e diturisë ndërsa ne mendojmë se fjala “sulltanë” ka për qëllime fuqinë absolute të

Allahut të Lartmadhëruar. Patjetër duhet të dëshmohet para gjithë botëve paaftësinë e tyre në atë që patjetër duhet besuar në fuqinë e absolute të Allahut.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. kur e bëri Isranë dhe është ngritur në qiellin e shtatë, e pastaj në sidretul Munteha, e ka bërë me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar.

Në ditën e kiametit ne do të jemi në çdo vend me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar. Melekët të cilët zbresin në tokë dhe ngrihen lart në qiell, e bëjnë me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar .

Po sikur ajeti “nuk mund të ngriheni vetëm se me fuqinë” nuk do ta kishte domethënien fuqinë e Allahut, atëherë disa njerëz do ta vinin në dyshim mrekullinë e Israsë dhe Miëraxhit. Mirëpo pasi që Israja dhe Miëraxhi ka ndodh kjo do të thotë se Allahu i Lartmadhëruar është Ai i cili bën çka do, dhe e ngrit në qiell çdonjërin që ai e parasheh dhe e përcakton.

Po nëse ndonjëri na thotë: Ja njeriu është ngritë në hapësira të tokës dhe qiellit pasi që ka arritur në hënë ne i përgjigjemi: Njeriu ka arritur të ngrihet lart dy sekonda të vitit të dritës e i kanë mbet edhe miliona vit drite e cila është pjesë e qiellit të kësaj bote. Ai pra nevojitet në lartësi të miliona vit drite, për të arritur në lartësi të qiellit të dynjasë të cilën ne e shohim ndërsa në lartësi përpos qiellit të dynjasë as që ka arritur. Pastaj, Shejh Shaëraviju këtë çështje shumë të rëndësishme e përfundon diku iu kundërvu atyre të cilët tentojnë që Kur’anin ta quajnë libër njeriu, ndërsa e harrojnë fuqinë e Allahut dhe i shikojnë vetëm çështjet sipërfaqësore për me i zhvillu problemet e tyre të cilat nuk janë të tyre sepse unë kur të ngrihem për disa minuta drite prej miliona vite drite rrugë nuk mund të them, por asnjë njeri i logjikshëm nuk mund të thotë se është ngritur në një lartësi të madhe prej milion vit drite e cila është në thellësi të qiellit të kësaj bote. Për këtë arsye, është e sigurt se mrekullia e Israsë dhe Miëraxhit është mrekulli e përgjithmonshme ajo do të jetë mrekulli e përgjithmonshme deri në ditën e kiametit. Dhe njeriu sado që do të ngrihet lartë, sado që do të zhvillohet dhe sado që do të arrij dituri ai kurrë nuk mund të arrij në horizontet, apo lartësitë e qiellzave dhe të tokës, por nuk do të mundet as në lartësitë e qiellit të tokës e mos të flasim në shtat qiejt. Pra për këtë arsye mrekullia e Israsë dhe Miëraxhit do të mbetet mrekulli i përgjithmonshëm dhe argument (shkencë) e cila thërret njerëzit në besim në Zotin dhe në fuqinë absolute të tij.

NAMAZI I BASHKËSHORTES ME BASHKËSHORTIN E SAJ

A pranohet namazi i gruas me bashkëshortin e saj?

Po, dhe ajo duhet të jetë në safë në vete.

Mirëpo nëse gruaja bëhet Imam ajo duhet të jetë në një safë me gratë (por pak përpara). Femra nuk lejohet të bëhet Imam i burrave.

NUK I NGJASON ASGJË

Zoti i Lartmadhëruar është cilësuar me cilësi precize ashtu që mendjen e njeriut e cila luhetet prej një ane në anën tjetër ta vendos në vijën e prerë, që mos ta imagjinoj këtë të ekzistuarit e Zotit për ta dhënë formë Krijuesit të Lartmadhëruar, ose me e cilësua Zotin e Lartmadhëruar me cilësi të shqisave të thjeshta të njeriut, të cilat janë të kufizuara dhe janë cilësi të krijesave.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Nuk ka të ngjashëm si Ai asgjë. Kjo sikurse po i thuhet njeriut: Lëne veten qetë nga çështjet e kota, për me i hulumtua çështjet të cilat nuk janë të Kandarit tuaj.

Çka mendon Shejh Shaëraviju në lidhje me pjesën e ajetit Kur'anor “Nuk ka të ngjashëm si Ai asgjë”.

Imami i nderuar thotë: Kur të dëgjosh psh. se Allahu i Lartmadhëruar ka këmbë, dëgjon e sheh, ti nuk di për këmbë e duar pos atë që e sheh në veten tënde, nuk e di të dëgjuarin pos ashtu siç e di në vetvete. Ne nuk themi: Dëgjimi i Allahut është i ngjashëm me dëgjinin e krijesave, sepse esenciale është “Nuk ka të ngjashëm si Ai asgjë. Të gjitha cilësitë dhe emrat të cilat janë të Allahut janë po ato cilësi të Krijesat, mirëpo ti përqendrohesh dhe po i përkufizon ato cilësi të cilat Allahu e ka cilësi veten.

Mënyra e atyre çështjeve nuk është domosdoshmëri e Imanit. Mënyra se si është diçka në një çështje nuk është domosdoshmëri e Imanit. Zoti ynë na ka tregu: Unë shikoj, unë dëgjoj, pra Ai ka të shikuarit, ai ka të dëgjuar, mirëpo ti mos e merr mënyrën të cilën e di të dëgjuarit dhe të shikuarit në krijesat dhe të thuash: Zoti ynë sheh dhe dëgjon si ne. Jo! Kurrsesi jo. Po shtrohet pyetja pse? Sepse ti dëshmon se Zoti ynë ekziston, krijesat ekzistojnë, mirëpo a janë krijesat si Krijuesi, pse të dëgjuarit e krijesave po e ngjason me të dëgjuarit e Tij, ose të dëgjuarit e Tij e ngjason me krijesat. Ti ndryshon, dhe e di se ndryshon prej Krijuesit. Allahu jeton, njeriu jeton por a është jeta ime si jeta e Tij. Ai jeton, ti jeton por a është jeta jote si jeta e Tij. Jo! Kurrsesi jo!

Çdo emër apo cilësi e Zotit i cili na ka ardhur në Kur'an dhe hadithë është edhe te njeriu. Ti tani gjendesh para dy çështjeve: As të mos bësh ngjasim, por as të mos i mohosh. T'i mohosh do të thotë: që ti të thuash: Jo, ai nuk ka dëgjuar, sepse të dëgjuarit është cilësi e njeriut. Ne themi: Ti po bën krahasim të dëgjuarit tënd i cili ka mjetin (veshin), dhe ti po e pastron Allahun nga kjo çështjeje. E vërtet është ashtu ti dëshiron me i përshkrua atij diçka, mirëpo pse nuk po e pranon tekstin Kur'anor. Ai ka thënë: Unë kam të dëgjuar, ti pranoje atë se ai ka të dëgjuar, mirëpo pastaj mënyra se si dëgjon nuk është çështja jote, se asnjëherë “mënyra” nuk është çështje e Imanit.

Imami i mirënjohur sqaron një çështje shumë të rëndësishme:

Ne kemi treguar një herë, kur e ka pyetur Zotin e Tij, çka e ka pyetur: Më trego (mënyrën) si i ngjallë të vdekurit? Zoti i ka thënë: A nuk po beson? Ai iu është përgjigj: Po, gjithsesi besoj, pra ai ka besuar mirëpo ai ka dashur ta kuptoj mënyrën “mirëpo që të më qetësohet zemra ime”. Ai i cili dëshiron me polemizua çështjen e thuktë, ai thotë se këtu ka kundërthënie, ju po thoni se Zoti ka thënë: mirëpo po jemi indiferent në atë se këtu ka kundërthënie.

Cili është kuptimi i Imanit? Iman do të thotë qetësimi dhe pushimi i zemrës në një çështje aq shumë sa që nuk të shkon ndërmend me bisedua me për atë çështje. Nëse fillon që edhe njëherë me diskutua për atë çështje, atëherë nuk ke arritur në shkollën e Imanit, që do të thotë ti veç e ke Imanin por ende po hulumton për të. Mendo Imani është qetësimi dhe pushimi i zemrës në një çështje dhe puna mori fund, dhe s'ka mbet hapësirë më që ta diskutosh çështjen e Imanit.

Përsërisim: “Gjithsesi po” do të thotë: kam besuar, por bëhet pyetja: Çka donë të thotë kam besuar? Do të thotë qetësimi dhe pushimi i zemrës në këtë çështje sa që as që më shkon ndërmend që të diskutoj edhe ndonjëherë. Mirëpo “Që të më qetësohet zemra ime”. Kërkimi i diçkaje që ka humbur prej saj, dhe përderisa unë kërkoj që të më qetësohet zemra, sikurse bëhet e ditur se ende nuk është arritur qetësimi i zemrës, përderisa ai qetësim po kërkohet, pra është e palogjikshme të kërkohet Imani me fjalën “po gjithsesi”.

Ne i themi atij: Ti po del prej teme, se ne po shikojmë pikësynimin e fjalëve. Pse, a mos ka thënë Ibrahim: O Zoti im, a ti i ngjall të vdekurit? Jo, nuk ka thënë ashtu, por ka thënë: Si i ngjallë të vdekurit? Pra kur bëhet pyetja “Si?” pra për mënyrën e ngjalljes, kjo do të

thotë se beson në ngjalljen por e dëshiron me pa formën e ngjalljes. Pra Ibrahim i a.s. ka besua në ngjalljen e të vdekurve, dhe kjo është çështja të cilës po e diskutojmë, dhe kjo është Imani, mirëpo pyetja si nuk është çështje të cilën e kërkon Imani.

PRANGOSJA E SHEJTANËVE NË RAMAZAN

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: Kur të vjen muaji Ramazan, hapen dyert e xhenetit, mbyllën dyert e zjarrit dhe prangosen shejtanët.

I DËRGUARI I ALLAHUT E KA FOLUR TË VËRTETËN

Prangosja e shejtanëve do të thotë të lidhurit e tyre izolimi dhe paralizimi i tyre për çdo aktivitet i cili nuk e lejon shpërndarjen e të mirës ose gjërave që sjellin mirësi. Mirëpo, ne shohim se shumica prej neve prangosen prej punëve të mira, ato i prek me fjalë tjera i përvetëson shejtani dhe i përvetësojnë xhinët, shohim gënjeshtarë, rrenacak, tradhtar, mashtrues, por edhe që hanë haptazi në ramazan, të gjitha këto janë shenja të qarta se ata janë të manipuluar prej shejtanit.

Pyetja është:

Si janë të prangosur shejtanët, dhe të mbyllur në ramazan pas të gjitha këtyre dukurive negative të përditshme. Disa fukah (dijetarë të jurisprudencës islame) këto dukuri i arsyetojnë me atë se janë të prangosur dhe të mbyllur vetëm një lloj i shejtanëve, ndërsa lloji tjetër jo!

Disa tjerë thonë se: Të gjithë shejtanët në përgjithësi janë të prangosur, dhe e vërtet është ashtu siç tregon hadithi po të gjitha punët e ndyta dhe amorale janë rezultat i njerëzve shejtan dhe të ngjashëm me ta, të cilët më nuk kanë nevojë që shejtani ti përvetësoj, t'i hutoj që të mos largohen prej punëve të këqijave dhe haramëve.

Mirëpo i nderuari ynë në lidhje me këtë çështje thotë: Kemi dy lloje të fjalive: Fjali lajmëtare, pra që tregojnë realitetin e kaluar, dhe fjali fillestare apo veprim formuese e cila ka për qëllim veprimin e tanishëm dhe të ardhshëm. Fjala vjen: Zoti i Lartmadhëruar në ajetin Kur'anor për Qaben thotë dhe kush hynë në të (Qabe) është i sigurt. Nëse kjo fjali ka për qëllim lajmërimin e së kaluarës, atëherë është e pamundur që të ndodh diçka çka është në kundërshtim me fjalën e Allahut, por nëse ka për qëllim fjalinë fillestare apo veprim formuese, atëherë ky ajet është urdhër prej Allahut për njerëzit që atë të cilët hynë në Qabe le të jenë të sigurt sepse ne në realitet mund të shohim që të ndodh e kundërta që mos të jenë njerëzit të sigurt në të, mirëpo kjo është sepse njerëzit nuk e kanë dëgjua urdhrin e Allahut.

Po ashtu nëse e shohim ajetin Kur'anor “ Të mirat për të mirët, të mirët për të mirat dhe të këqijat për të këqijtë e të këqijtë për të këqijat”. Në realitet shohim se ka të mirë për jo të mirat, dhe e kundërta, por esenca është se nëse e dëgjojmë fjalën e Allahut, dhe

veprojmë me të atëherë të mirët i martojmë me të mirat, por nëse nuk e dëgjojmë fjalën e Allahut ndodh e kundërta të mirët për jo të mirat. E njëjta është edhe me hadithin e prangosjes së shejtanëve, në hadith kemi fjalinë e cila ka për qëllim veprim formimin pra hadithi ka për qëllim “prangosni shejtanët” e ne nëse e dëgjojmë hadithin i prangosim shejtanët, mirëpo nëse nuk e dëgjojmë atëherë shejtanët nuk prangosën, pra ne jemi të urdhëruar që kjo me ndodhë që ata (shejtanët) me u prangosë.

PËRBETIM PËR MOSKONTAKTIM SEKSUAL ME GRUAN

Pyetje:

ILAË - siç thotë Err-Rragibi është përbetimi i cili ka të bëjë për pakësimin, apo mosveprimin e çështjeve për të cilën përbetuesi është përbetuar. Siç thotë Zoti i Lartmadhëruar: “Nuk përbetohet rrejtshëm”. Po ashtu ajeti kur’anor:

“Dhe të mos përbetohen të nderuarit prej mesit tuaj”. Mirëpo në terminologjinë e shariatit “IJLAË” është të përbetuarit e burrit për moskontaktim seksual me gruan e tij.

Përgjigje: Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Për ata që përbetohen për moskontaktim me gratë e tyre, afati i pritjes është katër muaj. Por nëse pendohen atëherë Allahu është Falës i Mëshirshëm.

Pra, thënia “afati i pritjes së tyre është katër muaj” ka për qëllim për me ndërprerë dhe me ndaluar. Pra iu është shtuar ndajfolja e kohës *katër muaj*. E kjo do të thotë se ndajfolja është kryefjalë, ndërsa para saj është kallëzuesi. I këtij mendimi është gramaticienti Ahfesh, pra e parashoh veprimin e tillë.

LUTJA PËR ZOTIN TIM DHE PËR MUA

Një beduin ka kërkua prej Muhamedit a.s. për t’ia mësuar një dua, Muhamedi a.s. ia mëson:

“LA ILAHE ILALLAHU VAHDEHU LA SHERIKE LEH ALLAHU EKBERU KEBIRA VELAMDULILAHU KETHIJRA VE SUBHANELLAHI RABIL ALEMINE VE LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAHIL AZIJZIL HAKIJME. E ai i ka thënë kjo është lutja për Zotin tim, por lutja për mua?

O Zoti Im, më mëshiro, më udhëzo, më furnizo, më fal, kjo dua përfshin këtë botë dhe botën tjetër.

TRANSMETON MUSLIMI

PREJ DUAVE TË NAMAZIT

Ebu Bekri Sidiki ka kërkua prej Muhamedit a.s. me ia tregu duan të cilën e thotë në namaz.

Muhamedi a.s. ka thënë:

O Zoti Im, unë i kam bërë vetës padrejtësi të shumta, ndërsa gabimet nuk mund ti fal askush pos Teje. Më fal më faljen Tënde, dhe më mëshiro. Vërtet Ti je Falës i Mëshirshëm.

MUTEFIKUN

ALEJHI

SHPIRTI

Dihet mirëfilli se njeriu përbëhet prej dy komponentëve: prej materies dhe shpirtit, po ashtu dihet se shpirti është prej Allahut dhe mëshirës së Tij, dhe se shpirti besnik, pra

Xhibrili është përcjellës e programit të Allahut, pra Kur'anit i cili po ashtu është shpirt, pyetja është: A është shpirti me të cilën Zoti i Lartmadhëruar e ka frymëzuar materien për ta lëvizur, për të **ndier në vërtetë** po ai shpirt cilën Allahu ia ka dhënë planprogramin të tij Kur'anit.

Përgjigje: Kurrresi jo, shpirti i parë është ai i cili është edhe në jetën e besimtarit edhe në jetën e pabesimtarit ndërsa shpirti i dytë është ai shpirt i cili i jep jetë lumturi të përgjithmonshme dhe jetë më me vlerë e kjo është ajo jeta e vërtetë.

ISLAMI DHE EDUKIMI I EPSHIT-NDJENJAVE

Shumë herë Shejh Shaëraviju ka sqarua se Islami nuk ka ardhur me i paralizua ndjenjat por përkundrazi ka ardh me i edukua, me i kënaq, e këtë e bëni për me sigurua njeriun prej shkatërrimit.

Në realitet shumica, në shumicën e rasteve i pasojnë epsheet e tyre, nuk i përmbahen planëprogramit të Allahut të Lartmadhëruar. Islami dhe mësimi i tij i pastër është për me mbrojt njeriun nga rrëshqitjet, nga gabimet dhe e siguron atë pasi që vazhdimisht ia tërheq vërejtjen njeriut për mos me ra në grackë të shejtanit.

Pyetja është: Cili është sekreti psikologjik i njeriut kur ai bënë prostitucion p.sh. ndërsa ai e di (qind për qind) plotësisht se është mëkat prej mëkateve të mëdha, mirëpo ai prapë e vazhdon për të dytën për të tretën.

Imami i nderuar përgjigjet në këtë pyetje: Njeriu i cili tejkalon kufijtë e tij dhe krekoset, është si rezultat i mos ndëshkimit dhe mos dënimit të tij për kryerjen e atij krimi.

Nëse njeriu bën krim dhe dënohet për atë krim, ai dënim është për të mirën e tij. Imami i mirënjohur sqaron një çështje shumë të rëndësishme kur thotë: Nëse shikojmë p.sh. dënimin për epshin seksual do të shohim se Zoti i Lartmadhëruar nëpërmjet atij dënimi dëshiron ta ruaj, ta mbroj dhe ta siguroj njeriun prej asaj çka e shkatërron atë dhe për ta siguruar po ashtu tërë shoqërinë.

Transmetohet se një njeri ka ardhur te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe i ka thënë: Unë të premtoj se i përmbahem ligjeve Islame dhe jam musliman mirëpo jam njeri i cili i dua gratë, femrat dhe nuk mund të largohem nga kjo (prostitucioni). A nuk po ma lejon këtë mua!? Muhamedi a.s. nuk e ka përdorë menjëherë forcën e ashpërsinë, por është sjell si edukatorë, ka dashur që atij njeriu t'ia mësoj urtësinë dhe qëllimin e ndalesës në atë mënyrë që ai njeri ta kuptoj dhe ta ndiej thellë në zemër. Muhamedi a.s. e ka pyetur: A dëshiron që kjo ti ndodh nënës tënde (që dikush tjetër pos babës tënd të kontaktoj seksualisht me të). Ai menjëherë me dëshpërim i thotë: Jo. Po a dëshiron që kjo ti ndodh motrës tënde? Ai prapë me dëshpërim i thotë jo! A dëshiron t'i ndodhë gruas tënde? Ai i thotë jo, jo. Po secili prej neve është ashtu (me nënë,grua, e motër) o vëllai ynë.

Kështu i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka dashur të sqaroj se qëllimi i ligjeve të Allahut është që të mbrohet nëna, motra, e gruaja gjë të cilën asnjë nuk dëshiron që tu ndodh e keqja.

Nëse çdo prostitutit gjatë prostitucionit të tij i kujtohet ky dialog dhe e kujton nënën e tij, motrën e tij dhe gruan e tij do të largohet menjëherë nga prostitucioni.

Pra dispozitat e sheriatit janë për t'i edukua dhe për ta forcua epshin, dhe çdo dispozitë është për me sigurua individin dhe shoqërinë. Islami nëse ta përkufizon një liri, ai me të e pengon tjetrin me keqpërdorë të drejtën tënde, nderin tënd.

JA RAB (O ZOT !) DHE DËSHIRA ABSOLUTE

Ku po jetë dëshira absolute e cila është në librin e Allahut, dhe cila është ndërlidhmëria e saj dhe pranimit të duarës së besimtarit, kur t'i ngritë duart lartë dhe thotë "O ZOT !".

Imami i mirënjohur Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Fjala: O Zot? Kur të buron nga zemra e atij të cilët iu është bërë padrejtësi. Nuk ka forcë as fuqi të ndryshoj diçka por është rezultati i fuqisë së Allahut i cili e ka caktuar ligj (siç i ka caktuar ligjet) hyjnorë, pra ligj të Tij, pra ligj të shkaqeve, që do të thotë ai i cili klith O Zot? Atëherë është ligj që shkaqet të mos funksionojnë dhe realizohet "Nuk ka fare as fuqi të ndryshoj atë që Ai cakton". Nga kjo themi se atij si ka mbetë asgjë tjetër përpos që me i ngrit duart në qiell dhe me kërkua fuqinë absolute, sepse vetëm ajo lutje është mjeti i fundit i cili me ia kthye të dobët, të drejtën e tij, që me iu kthye e drejta prej të padrejtësisë të ai të cilit iu është padrejtësi. Zoti i Lartmadhëruar fuqinë e Tij dhe caktimin e Tij absolut nuk e ka fshehur nga ne, por përkundrazi në shumë në shumë ajete të Kur'anit hasim nëse e lexojmë atë: "me mëshirën e Tij e veçon kë të donë Ai", "e dënon atë që do Ai", "e falë atë që do ai", "e ngrit lartë kë të do Ai, dhe e zbret poshtë cilin do Ai", "i jep pushtet dhe pushtim atij që do Ai, dhe e zbret nga pushteti atë të cilin do Ai". Vërtetë "Allahu ka mundësi për çdo send".

Pra, po shohim se Zoti i Lartmadhëruar në këto ajete, dhe në ajetet tjera na ka treguar qartë fuqinë e Tij absolute, ndoshta fuqia absolute dhe rezultati kulminant i kësaj është i shprehur në ajetin Kur'anor "Vërtetë, çështja e Tij (Allahut)" është se kur dëshiron diçka, mjafton që vetëm me i thënë asaj çështjeje bëhu dhe ajo bëhet menjëherë.

Kjo për arsye se ky ajet na tërheq vërejtjen se për Allahun nuk funksionon shkaqet, edhe pse ai i ka krijuar ato shkaqe për me organizuar sistemin e jetës në tokë. Po të kishim qenë shkaqet diçka përfundimtarë për Allahun. Zoti i Lartmadhëruar në ajet Kur'anor do të kishte thënë "Vërtetë Ai kur të dëshiron diçka i përgatit shkaqet dhe rrethanat që të bëhet", por fjala "bëhu" do të thotë se shkaqet janë të paralizuara dhe se vetëm fjala "bëhu" bën që të bëhet pa shkaqe dhe rrethane.

Kështu, krijimi i qiejve është bërë me "bëhu" krijimi i njeriut është bërë me fjalën "bëhu" dhe dëshira e tij mjafton dhe i mjafton vetëm fjala "bëhu".

Këtë çështje Shejh Shaëraviju na sqaron më shumë me rastin e tregimit të Ibrahimit kur është hedhur në zjarr, pse cilësi e zjarrit është që ai me djegë, por Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "O zjarr bëhu i ftohtë dhe sjellë qetësi Ibrahimit". Në atë moment cilësia e zjarrit e cila është djegia u bë cilësi e cila nuk djeg dhe nuk lëndon.

INSPIRIMI (NGULITJA NE ZEMËR-MENDJE)

Të gjithëve po na intereson një çështje, cili është dallimi në mes të asaj: vendosje në zemër, ngulitje në zemër dhe ideve të njeriut, sepse çdo njeriut mund t'i vjen një ide në mendje.

Imami i mirënjohur Shaëraviju thotë:

Ai i cili vendos, ngulit në zemër bëhet nëpërmjet përcjelljes në zemër dhe se ajo është prej Allahut dhe ai "mendim" është i drejtë dhe i vërtetë, nuk ka dyshim në të sepse: ne kur kemi treguar me rastin e nënës së Musa a.s.: Ne e kemi inspiruar (e kemi vendosur në zemrën e saj) jepi gji dhe nëse e ndien frikë (se ta marrin) hidhe në det e mos u pikëllo, as mos u brengos, sepse Ne prapë do ta kthejmë tek ti, dhe do ta bëjmë prej pejgamberëve.

KASAS

Kemi thënë: A dëgjoi dhe veproi nëna e Musaut apo jo? Natyrisht se po, ajo dëgjoi dhe veproi. Dëshiroj ta di cila nënë nuk pikëllohet dhe nuk brengoset për fëmijën e saj, nëse

un i them hidhe në det fëmijën tënd e mos u brengos. Cila logjikë e pranon këtë, kush e beson po mos të kishte ardhur kjo ide dhe ky mendim në zemër jo prej njeriut, as prej shejtanit por vetëm Allahut. Nuk do ta kishte bërë nëna e Musa a.s. një gjë të tillë e cila është në kundërshtim me natyrshmërinë dhe logjikën e njeriut. Si me i dhënë përparësi vdekjes së sigurt (hedhjes së fëmijës në det) prej vdekjes së dyshimtë (me mbajt fshehtas). Pra inspirimi (ngulitja në zemër) është ide nga lartë poshtë (prej Zotit te njeriu).

ËSHTË PREJ KADERIT TË ALLAHUT

Një arab (beduin) e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: O i Dërguari i Allahut: A të mjekohemi? Është përgjigjur: Po, sepse Ai i cili e ka zbritur sëmundjen e ka zbritur edhe mjekimin (ilaçin). E mëson ai i cili studion, dhe nuk e mëson ai i cili e **inpron**. Mjekohuni, vetëm se mos u mjekoni me haram.

E KA REGJISTRUAR

AHMEDI

Në Sunen disa arab (beduin) e kanë pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: A të mjekohemi? Është përgjigjur: Po! Rob të Allahut mjekohuni, sepse Allahu nuk ka vendos sëmundje e të mos ketë vendosë shërimin (mjekimin) e saj përpos një sëmundje. E cila është ajo o i Dërguari i Allahut?

Ajo është pleqëria.

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: Çka mendon nëse përdorim Rukje për shërim, apo ilaçe për shërim, a nuk e kthen (e largon) kaderin e Allahut? Është përgjigjur: Po mu ajo është kaderi i Allahut.

E KA REGJISTRUAR

TIRMIDHIU

Mjekimi në spital po ashtu është prej kaderit të Allahut.

Përgjigje: Në lidhje me këtë Shejh Shaëraviju jep mendim shumë të rëndësishëm: Mjekësia mjekon, ndërsa Allahu shëron. Mjekimi mund t'ia qëlloj por edhe mund të gaboj, sepse shumica e pacientëve vdesin mu në duart e mjekëve të tyre-SUBHANALLAH.

Imami i nderuar thotë: Mjeku i cili ia ka qëllua me diagnozën e tij dhe shëron ai nuk e ka largu kaderin e Allahut.

TOKA ËSHTË XHAMI DHE E PASTËR

Pyetje: I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: Jam i privilegjuan ndaj pejgamberëve tjerë me 6 gjëra: Më janë dhënë të gjitha njohuritë, jam i ndihmuar me atë se tjerët ma kanë frikën, më është lejuar teprica e pasurisë prej frontit, toka më është bërë xhami dhe e pastër, jam vula e pejgamberëve dhe do të bëj shefat në ditën e kiametit.

Në thënien e të Dërguarit s.a.v.s. më është bërë toka xhami dhe e pastër: Na vendos neve në tavolinë një çështje përfundimtare e ajo është se falja e namazit për çdo person është e lejuar absolutisht në çdo vend.

Ku është dallimi në mes të faljes së namazit në çdo vend dhe faljes së namazit në xhami?

Imami i mirënjohur Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Toka është e pastër dhe xhami, ka vende ku lejohet të falet namazi e po ashtu lejohet të zhvillohet aktiviteti jetësorë. P.sh. Në fabrikën tënde, ti edhe punon edhe falesh, në arën tënde edhe mbjell, por edhe falesh, në objekte arsimore edhe mund të studiosh por edhe të falesh në të. Pra në vendet publike lejohet edhe namazi por edhe veprimtaritë tjera jetësore.

Mirëpo nëse dëshirojmë që ndonjë vend ta veçojmë vetëm për namaz, themi: Ky është vend ku nuk zhvillohen aktivitetet e jetës por është e veçuar vetëm për namaz, atëherë këtë vend e quajmë Xhami, mesxhid apo shtëpi e Zotit. Për këtë arsye Muhamedi a.s. ka thënë: Mos lidh kontratë tregtie derisa të jesh në xhami, e po ashtu as me kërkua send të humbur aty, pse aty ishte koha ku do të takohesh me Zotin tënd e nuk lejohet me qenë indiferent ndaj tij. Mjafton që ti i ke 24 orë në disponim, e prej atyre 24 orëve një orë me e nda për me u taku me Zotin, e në at orë largohesh prej aktivitetit të jetës. Pra përcaktimi i vendit për xhami është vetëm për namaz, e papërcaktimi i vendit është edhe për namaz edhe për aktivitetet tjera të jetës. E atë vend të cilin e përcaktojnë njerëzit me dëshirën e tyre e quajnë shtëpi e Allahut.

Pra shtëpia e Allahut (Qabja) në Meke është përcaktua me dëshirën e Allahut ndërsa shtëpitë e Allahut (xhamit) tjera janë përcaktua me dëshirën e vetë njerëzve. Atëherë shtëpitë e Allahut të përcaktuara me dëshirën e njerëzve janë zinxhirë, apo vazhdimësi e shtëpisë së Allahut me dëshirën e Allahut.

EPSHI I KAFSHËS

Te intelektualët dhe te jo intelektualët, dhe te njerëzit në përgjithësi paraqitej nevoja e të njohurit të kontaktit seksual te kafshët, dhe sundimi i epshit të tyre. Duke krahasua njeriun me epshin e kafshës. Ndoshta kjo është se kur epshi e sundon trupin dhe i dirigjon pjesët e tij atëherë logjika (mendja) humbet dhe depërton shejtani, kështu që njeriu zbret në shkallën e kafshëve që do të thotë se ai funksionon vetëm nëpërmjet të indikacionit të epshit, apo vetëm reflektim i epshit ashtu siç thonë edhe mjekët.

Mirëpo Imami i nderuar Shejh Shaëraviju këtë çështje e shpjegon nga një kënd tjetër ku thotë: Instikti i epshit të kafshës është për ta ruajtur llojin. Pra është ndjenjë vetëm për ta ruajtur llojin, ajo është e patjetërsueshme që do të thotë epshi vetëm e kryen detyrën e tij.

Kur mashkullori bashkohet me vezorin në embrion fryhet dhe femra jetë shtatzënë (barsë), pra sikurse të fryrit do të thotë unë jam ajo që barroj.

FOTOGRAFIA E XHAMISË NË QIBRIT

Ishin në shtëpinë e Imamit kur erdh Shejh Shaëraviju ed. Dr. Muhamed Tajib Nexhor Degon i Universitetit të Ez-herit. Njëri prej prezentëve e pyeti Dr. Nexharit për fotografinë e xhamisë në Qibrit, a është e lejuar apo e ndaluar, kur dihet se Qibriti pas harxhimit të kokrrave gjuhet në tokë.

Dr. Nexhari u përgjigj se lejohet.

Kjo për arsye se veprat shpërblehen sipas qëllimit, dhe çdo njeri do të shpërblehet ashtu siç e ka qëllimin ashtu siç na ka mësuar i Dërguari i Allahut s.a.v.s.

A PYETET I DËRGUARI I ALLAHUT S.A.V.S. NË DITËN E KIAMETIT

Pak para se të botohet kjo libër një motër muslimane na ka dërgua një pyetje dhe e parapashë që t'ia bashkëngjis këtij numri, dhe u përgjigja prej asaj çka kam mësuar prej diskutimit të Imamit të nderuar Muhamed Muteveli Shaëravijut me prof. dr. Muhamed Ibrahim Shafiju dhe prof. dr. Abdul Kerim Dihjete.

Pyetje: A pyeten të Dërguarit e Allahut në ditën e kiametit apo jo?

Përgjigje: Po, pyeten të Dërguarit e Allahut në ditën e kiametit. Këtë na e tregon Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an: "Dhe do t'i pyesim ata të cilëve u kemi dërguar pejgamber, por do t'i pyesim edhe te pejgamberët.

EL EARAF

"Atë ditë kur Allahu do t'i tuboj pejgamberët dhe do t'u thotë:

"Çfarë përgjigje keni marrë prej tyre? Ata do të përgjigjen: Nuk dimë asgjë".

EL-MAIDE,

109

Dhe si do t'u vijmë secilit popull me dëshmitarë, ndërsa këtyre do t'u sjellim juve dëshmitarë.

EN-NISA

Unë frikohem se nëse bëjë mëkat ndaj Zotit tim do të dënohem në Ditën e Madhe (Ditën e Kiametit).

"Dhe i Dërguari thotë: O Zoti Im ! Populli im këtë Kur'an e kan konsiderua si çështje e harruar" (e lënë pas dore).

Të gjitha këto ajete dëshmojnë se pejgamberët do të pyeten në ditën e kiametit.